



SHKOLLA VERORE E BULLGARISHTES

Shkolla Verore e Bullgarishtes do të zhvillohet në periudhën **1-10 korrik 2021** pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Kjo shkollë verore e para e këtij lloji në vendin tonë organizohet nga Departamenti i Gjuhëve Sllave-Ballkanike dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në kuadër të Programit Erasmus + që Universiteti i Tiranës ka me Universitetin Veliko Tërnovo “St.Shën Kirili dhe Metodi” të Bullgarisë.

Ajo synon t’u mundësojë studentëve të nivelit Bachelor dhe Master, si dhe studentëve të tjerë të interesuar, përvetësimin e bullgarishtes, në nivelet A1 – B1

Në të njëjtën kohë, studentët pjesëmarrës në këtë shkollë, përmes leksioneve dhe referateve që do të mbahen nga profesorë dhe studiues të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Veliko Tërnovo dhe institucioneve të tjera shkencore në vend, do të pajisen me njohuri shtesë mbi marrëdhëniet historike, gjuhësore, letrare, trashëgiminë kulturore bullgare në Shqipëri.

Stafi mësimor do të përbëhet nga profesorë dhe studiues specialistë të këtyre çështjeve të Universitetit të Tiranës dhe të Universitetit Veliko Tërnovo “St.Shën Kirili dhe Metodi” të Bullgarisë.

Leksionet të mbahen nga pedagogë bullgarë dhe shqiptarë

Këtë vit, Shkolla Verore e Bullgarishtes do të zhvillohet në **2 nivele**:

- 1. Niveli fillestar**
- 2. Niveli i mesatar**

Për çdo nivel do të pranohen nga **15 studentë**.

Aplikimet për shkollën verore do të kryhen deri në dt. **29 qershor 2021** pranë Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe në adresën elektronike: rbelo@abv.bg

Me përfundimin e shkollës verore, të gjithë studentët do të pajisen me **certifikata të pjesëmarrjes**.